




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P. “FIDANI L”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.T.P. “FIDANI L” e dt. 28.07.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 28.05.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 28.05.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.P. “FIDANI L”, me datë 28.07.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:


Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupi Operatorëve Ekonomik **“Company Bejta” SH.A. & N.P.SH.”Eltoni Com” & “Eurocom” sh.p.k**, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës